

CIVIL SECURITY IN KOSOVO AND CHALLENGES

Fatos Rushiti

Ardian Emini

fatos.rushiti@hotmail.com

Abstract: Kosovo is positioned in a very strategic position on the West Balkan, facing with the challenges of building the state and building of the democracy on the other side, the interference by Serbia and impact on internal affair. As one of the newest states in the region, actually Kosovo functions with its fragile institutions and those in the field of security and at the same time has a permanent need for USA and UE. My analyze aims to clarify the ability, capacity and the actions of the Kosovo institutions in the field of national security focusing the time after the declaration of independence up to now.

The fact that the crisis of emigrants is still present, so Kosovo is very hard to be avoided from the aspect of territorial crossing and the other issue because a great number its citizens that joined ISIS, the open issue about the demarcation with Montenegro and the forming of the Association for the Serbian municipalities, makes me more interested about the approach of the Kosovo government and the dependable institutions toward the challenges mentioned above.

The strategic position of Kosovo, besides creating the opportunity to make our country a target of transit, illegal activities and various trafficking, also poses a risk to the distribution of terrorism syndrome, especially those based on religious fundamentalism.

Looking at this prism my focus will be the human security and with special emphasis the minorities like Serbian minority and the others who live and act in the territory of Kosovo.

Keywords: Challenges of state, Kosovo, national security, Serbia, etc

SIGURIA QYTETARE NË KOSOVË DHE SFIDAT

Fatos Rushiti

Ardian Emini

fatos.rushiti@hotmail.com

Rezime:Ky punim me titull “ Siguria qytetare ne Kosovw dhe sfidat”, i shqyrton dilemat e sigurisë dhe sfidat e mbrojtjes së Kosovës, përfshirë ato me Serbinë, si dhe perspektivat për një bashkëpunim zyrtar të mundshëm me NATO-n.

Parë në këtë prizëm, punimi shkencor ofron një grumbull hulumtimesh shkencore si ato teorike, metodologjike, praktike, konkluzioneve dhe rekomandimesh për modalitetet e mundshme të sigurisë nacionale dhe atë njerëzore të Republikës së Kosovës. Për sigurinë e shtetit thelbësore mbetet dialogu i mundshëm mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve të mbrojtjes, për komponentet e dialogut të strukturuar të NATO-s me Kosovën, për përmbajtjen e synimeve armiqësore të Rusisë në Ballkanin Perëndimor, si dhe për rregullimin e përpiktë të luftës kundërterrorizmit nga ana e forcave ushtarake të vendeve të rajonit gjithmonë duke pasur parasysh sfidat e shtetit të Kosovës në politikat e sigurisë nacionale dhe ato ndërkombëtare.

Ky punim synon të analizojë preventivën, sjelljen institucionale dhe planifikimin strategjik në fushën e sigurisë të institucioneve shtetërore të Kosovës. Poashtu analiza në këtë punim synon ti vë në pah problemet kryesore me të cilat ballafaqohen institucionet e Kosovës drejt një mbrojtje më të suksesshme të sigurisë së qytetarëve të saj

ÇËSHTJET E SIGURISË DOMOSDOSHMËRISHT SI PRIORITARE

Bazuar në momentin aktual dhe shumë të ndjeshëm në të cilin gjendet Republika e Kosovës pas pavarësisë së saj, çështjet e sigurisë domosdoshmërisht shtohen si prioritare. Në fakt, periudhën pas statusore po e karakterizojnë dhe po e bëjnë mjaftë të ndjeshme rrethanat, kërcënimet dhe rrezikshmëritë shumë. Një ndër to është edhe situatë shumë

e vështirë ekonomiko-sociale e njëpjese mjaft të madhe të popullatës. Në këtë kontekst duhet theksuar edhe vështiresitë dhe problemet tjera që kanë të bëjnë me korrupsionin, nepotizmin, krimin e organizuaretj.¹⁹⁰

Pozita qendrore të cilën e zë Republika e Kosovës në hapësirën ballkanike, në aspektin gjeografik e gjeopolitik mund t'i krijojë mundësi trafikeve ilegale dhe aktivitetëve terroriste. Në këtë mënyrë ndërtimi i një ambienti të qetë dhe të sigurtë për të gjithë komunitetet të cilët jetojnë në Kosovë është detyrë shumë e rëndësishme. Poashtu, është tejet e rëndësishme që strukturat përkatësisht institucionet e sigurisë, duhet të jenë plotësisht në kontrollin demokratik, duke pamundësuar asnjë lloj zbrastësie e cila do të mund të kontribonte në brishtësinë e tyre.

GJENDJA E SIGURISË PARAQET FENOMEN KOMPLEKS

Gjendja e sigurisë paraqet fenomen kompleks, i cili jep pasqyrë të vëllimit dhe intensitetit të më shumë elementeve të kërcënimit të sigurisë kombëtare rreziqe, kërcënime dhe sfida, të cilat në një kohë të caktuar veç e veç ose të kombinuara ndikojnë mbi sigurinë e qytetarëve, komunitetit ose mbi një çështje konkrete të rrezikimit dhe mbi shtetin. Gjendjen e sigurisë e përbëjnë më shumë faktorë ose indikatorë.¹⁹¹ Ata tregojnë se si është gjendja e sigurisë sa u përket pyetjeve në lidhje me rendin dhe qetësinë publike, dinamikën e krimin e cila ndikon mbi sigurinë personale, mbi sigurinë e të mirave të fituara materiale të qytetarëve dhe mbi pronën shoqërore, ndikimin e elementit të huaj mbi sigurinë e brendshme, kërcënimet të cilat rezultojnë nga organizata ekstremiste, zhvillimin e ngjarjeve të sigurisë në rajon dhe në botë, marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit e të tjera.

Gjendja e sigurisë në Republikën e Kosovës është rezultat i marrëdhënieve në shoqëri, të cilat në thelbin e tyre i kanë ngjarjet historike, dinamikën e zhvillimit shoqëror, marrëdhëniet brenda në shtet midis qytetarëve dhe subjekteve politike, marrëdhëniet me fqinjët dhe karakteristikat e gjendjes së sigurisë së përgjithshme në Evropë. Gjendja e sigurisë bazohet mbi vlerësimet e sigurisë të cilat nënkuptojnë analizimin e gjendjeve të sigurisë me metoda të cilat janë karakteristike për shkencën e sigurisë, politike dhe shkenca të tjera shoqërore.¹⁹²

Përkufizimi i gjendjes së sigurisë është veçanërisht i dobishëm për shkak të parandalimit të kërcënimeve të sigurisë, për shkak se mundëson krijimin e skenarëve të sigurisë mbi bazë të parametrave të përcaktuar paraprakisht.¹⁹³

MASAT KUNDËR TERRORIZMIT

Republika e Kosovës kërcënohet edhe nga grupet apo organizatat e ndryshme terroriste ndërkombëtare, të cilat mund të kenë si cak prezencën e madhe ndërkombëtare në Kosovë për shkak të angazhimit të tyre në luftën globale kundër terrorizmit. Pozita gjeostrategjike e Kosovës përveç që krijon mundësinë për të bërë vendin tonë si cak transitit, për aktivitete ilegale dhe trafike të ndryshme, po ashtu kjo pozitë paraqet rrezik edhe për shpërndarjen e sindromit të terrorizmit veçanërisht të atij me bazë të fundamentalizmit religjioz. Në frymën e kësaj edhe përbërja religjioze e popullatës sonë me shumicë islame mund të përdoret si element për zgjerimin e influencës në regjion. Shpeshherë kjo përbërje mund të shfrytëzohet si alibi për të ndryshuar fokusin nga elementet tjera që janë prezent në Kosovë dhe Rajon e që për qëllime politike të paraqesin Kosovën si vend i cili strehon, mbron, rekruton, trajnon dhe sponsorizon terrorizmin.

ROLI I INSTRUCIONAVE DHE PËRCJELLJA E SITUATAVE KËRCNUESE

Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Agjencia Kosovare për Inteligjencë, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës Mbështetur në legjisllacionin në fuqi, institucionet për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit janë por nuk kufizohen vetëm në këto:

- Ministria e Punëve të Brendshme-përmes mekanizmave të saj,

¹⁹⁰Nëse trashëgimia e protektoratit të OKB-së la sfida për mbikqyrësit e ardhshëm të Kosovës, megjithatë ofroi ca mësim të dobishme. Për një dekadë, UNMIK-u kontrollon si formën e institucioneve, ashtu dhe karakteristikat e zbatimit, prandaj edhe do të ketë mundur që tërthorazi të ndikonte edhe në zhvillimin e „normave joformale” që sundonin në Kosovë.

¹⁹¹Carl Schmitt “Constitutional Theory”, Duke University Press, London 2008, f. 182.

¹⁹²Gjendja e sigurisë paraqet fenomen kompleks, i cili jep pasqyrë të vëllimit dhe intensitetit të më shumë elementeve të kërcënimit të sigurisë kombëtare (rreziqe, kërcënime dhe sfida), të cilat në një kohë të caktuar veç e veç ose të kombinuara ndikojnë mbi sigurinë e qytetarëve, komunitetit ose mbi një çështje konkrete të rrezikimit dhe mbi shtetin. Gjendjen e sigurisë e përbëjnë më shumë faktorë ose indikatorë.

¹⁹³Nuk është në konflikt me realitetin nëse thuhet se kuptimi më i gjerë për sigurinë në Evropë, i cili ka të bëjë me sigurinë e bashkësisë transatlantike, ka ndikim mbi sigurinë e Republikës së Maqedonisë

- Policisë së Kosovës dhe
- Departamentit për Menaxhim të Emergjencave

Ndihmon në sigurimin e informacioneve si dhe ndërmerr aktivitetet në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve terroriste; Këshilli i Sigurisë së Kosovës është organ i cili analizon, vlerëson dhe rekomandon politikat e parandalimit dhe luftimit të terrorizmit në pajtim me legjislacionin në fuqi.¹⁹⁴

AGJENCIA KOSOVARE PËR INTELIGJENCË

Agjencia Kosovare për Inteligjencë- është organ i cili mbledhë dhe përcjell informacion në lidhje me kërcënimet nga aktivitetet terroriste ndaj sigurisë së Kosovës; Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës- përmes mekanizmave të vet organizativ ndihmon në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit; Ministria e Ekonomisë dhe Financavepërmes Doganave, Qendrës së Inteligjencës Financiare dhe Administratës Tatimore do të ndihmojë në parandalimin e qarkullimit ndërkufitarë të mallrave dhe materialeve të cilat kanë për qëllim veprimtaritë terroriste si dhe ndihmon në identifikimin, raportimin dhe bllokimin e financimit të aktiviteteve terroriste; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal- përmes mekanizmave të pushtetit lokaldo të ndihmojë në identifikimin e elementeve të cilat mundë të qojnë në veprimtaritëterroriste dhe të marrë pjesë aktive në parandalimin dhe përgatitjen apo reagimin ndaj aktiviteteve terroriste; Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë luan rol të rëndësishëm nëparandalimin e terrorizmit nëpërmjet edukimit, përmes plan-programeve mësimore,qa sjes ndër-programore dhe aktiviteteve të ndryshme jashtë-programore.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - përmes programeve për parandalimin e terrorizmit ofron trajnime dhe aktivitete vetëdijësuese për OJQ dhe grupet jo formale; Koordinatorin Nacional Kundër Terrorizmit është një strukturë e re mandati i të cilit është të koordinojë, bashkërendojë, monitorojë dhe të raportojë mbi implementimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve kundër terrorizmit;

Sekretaria e Koordinatorit Nacional Kundër Terrorizmit do të jetë organ roli i së cilës do të konsistojë në mbledhjen e të gjitha informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera në situatë normale me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të atyre informatave si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional kundër Terrorizmit.

QENDRA E SITUATAVE DHE SFIDAT

Qendra e Situatave, shërben si qendër operacionale për mbledhjen e informatave, analizave themelore dhe mbështetjes për menaxhim të krizave; Prokuroritë dhe Gjykatat, janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen penale të terroristëve, ndëshkimin adekuat të tyre, për konfiskimin e pasurisë dhe asetëve të fituara me anë të aktiviteteve terroriste. Në kuadrin institucional, një rol të rëndësishëm për parandalim dhe luftim të terrorizmit luajnë edhe Institucionet tjera vendore dhe institucionet ndërkombëtare partnere , prezente në Kosovë por edhe jashtë saj.¹⁹⁵

Mediat e ndryshme vendase dhe ndërkombëtare vazhdimisht kanë shkruar se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të Kosovës u janë bashkuar organizatave terroriste në lufrat në Siri dhe Irak. Një studim i bërë nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, (QKSS), thuhet se deri në muajin janar të këtij viti, 232 qytetarë të Kosovës kanë shkuar në Siri dhe Irak për të luftuar. Të paktën 30 nga ata kanë humbur jetën në këto lufrat.

Një valë masive e arrestimeve në Kosovë ndodhi në gusht të vitit të shkuar, ku Prokuroria Speciale e Kosovës kishte hapur hetimet kundër 57 personave dhe të njëjtën kohë kishte arrestuar mbi 40 prej tyre. Nga ky grup 32 persona tashmë janë akuzuar, për 18 persona kanë pushuar hetimet ndërsa, 7 persona të tjerë të kërkuar ndodhen në arrati. Personat e arrestuar dyshohen për veprat penale, "rekutim për terrorizëm", "organizim dhe pjesëmarrje në grupe terroriste" dhe "mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve".

Për disa nga të akuzuarit sipas Prokurorisë Speciale të Kosovës, ekziston dyshimi i bazuar se ata i janë bashkuar për të luftuar grupit terrorist (ISIS) në Siri, disa të tjerë kanë bërë thirrje për t'iu bashkuar grupit terrorist "ISIS", ndërkaq disa të tjerë kanë rekrutuar njerëz për t'i dërguar në luftën e Sirisë dhe njëkohësisht kanë mbledhur fonde për organizatat që tashmë janë të shpallura organizata terroriste nga Kombet e Bashkuara. Parlamenti i Kosovës në

¹⁹⁴ Sekretaria e Koordinatorit Nacional Kundër Terrorizmit do të jetë organ roli i së cilës do të konsistojë në mbledhjen e të gjitha informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera në situatë normale me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të atyre informatave si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional kundër Terrorizmit.

¹⁹⁵ Shih "Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit", marrë nga faqja elektronike : <file:///D:/Strategjia%20e%20kosoves%20kunder%20terrorizmit.pdf>

fillim të këtij viti ka miratuar ligjin që synon parandalimin e qytetarëve të Kosovës për tu bashkuar në luftëra jash të vendit. Hapat konkret që janë ndërmarrë për luftën kundër terrorizmit, janë: Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të Kosovës, si dhe hartimi i strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, që shpie në terrorizëm, që udhëhiqet nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës¹⁹⁶.

Paralajmërimi i fundit i Departamentit amerikan të Shtetit se Kosova është një ndër vendet me rrezikshmëri të lartë të terrorizmit, shihet me këndvështrime të ndryshme nga njohësit e çështjeve të sigurisë në vend. Një vlerësim të tillë, dikush e cilëson si jo të duhur pasi nuk ka rrezik për sulme, për sa kohë që dikush tjetër, thotë se renditja për Kosovën si vend i rrezikuar nga terrorizmi është rrjedhë e dimensioneve të sigurisë dhe brishtësisë së shtetit të Kosovës, shkruan AktivPress. Profesori i shkencave të sigurisë, Avni Islami është në grupin e të parëve. Ai ka deklaruar për Aktiv Press se një rrezik i tillë qëndron vetëm nëse një raport i tillë i është drejtuar qytetarëve amerikanë, pasi siç thotë ai Kosova nuk është dhe nuk do të jetë edhe për një kohë target i sulmeve terroriste. “Raporti i Departamentit amerikan të Shtetit, ku Kosova radhitet në shkallën e dytë të rrezikshmërisë sa i përket terrorizmit krahas vendeve të siç është Turqia dhe vendet e tjera, mendoj por edhe besoj që nuk është vlerësim i duhur në këto rrethana çfare është Kosova”, ka thënë Islami. Nëse DASH, siç thotë ai, i ka bërë vlerësimet për qytetarët e vet, atëherë edhe mund të jetë ashtu, por assesi nuk qëndron që populli i Kosovës dhe institucionet e Kosovës janë apo do të jenë objekt i sulmeve terroriste.

Këtë bindje Islami e argumenton me faktin se Kosova nuk është vend i vendimmarrjes dhe nuk është ajo e cila i bën politikat globale. “Si e tillë, Kosova nuk ka peshë në gjeopolitikë”, ka thënë Islami. Ai ndër të tjera ka shtuar se në rast të ndonjë rreziku, qytetarët janë të mbrojtur nga institucionet relevante të sigurisë. “Gjendja e sigurisë së përgjithshme është stabile dhe se për një kohë të gjatë po e ritheksoj se Kosova nuk rrezikohet nga sulme terroriste. Vendi ynë nuk është target i terroristëve”, ka deklaruar bindshëm Islami. Ky njohës i çështjeve të sigurisë beson se renditja e Kosovës si shtet me rrezikshmëri të lartë të terrorizmit nga Departamenti i Shtetit Amerikan mund të ketë ardhur pas numrit të kosovarëve që janë pjesë e luftërave në Siri.

Ky vlerësim nga DASH-i ka mundur të vjen për shkak se Kosova ka pjesëmarrës në numër të madh në luftërat e ISIS-it, por që po e ritheksoj se duhet të kenë kujdes objektet siç janë ambasadat, atashetë e të tjera, ndërsa qytetarët e Kosovës nuk kanë pse të shqetësohen për sulme terroriste, ka përfunduar Islami.¹⁹⁷

MITROVICA E VERIUT PASOJAT DHE SFIDAT

Kontesti territorial mbi Veriun e Republikës së Kosovës përbën njërin nga problemet themelore të sigurisë jo vetëm në Republikën e Kosovës, por edhe më gjerë në rajon, përfshi këtu edhe Republikën e Maqedonisë meqenëse paraqet njërin nga kontestet më serioze territoriale në rajon. Veriu i Kosovës nuk gjendet në kontrollin efektiv të pushtetit kosovar që nga viti 1999, me ç'rast aty ballafaqohen dy qëllime diametralisht të kundërta, edhe atë: nga njëra anë, është qëllimi legal dhe plotësisht legjitim i shtetit të Kosovës që konform Kushtetutës dhe legjislacionit të saj, synon shpërbërjen e kësaj pjese të territorit nga ndikimi i shtetit të Serbisë dhe integrimin e saj në kornizën shtetërore kosovare si dhe kontrollimi i kufirit me Serbinë (meqë sundimi i rendit dhe i ligjit përbën qëllimin themelor të çdo shteti bashkëkohor në botë), dhe nga ana tjetër, qëndron qëllimi i shtetit të Serbisë që sa më gjatë të mbajë në jetë ndikimin e tij mbi serbët që jetojnë në Veri, me qëllim që të ruajnë këtë territor si një lloj të vetëkënaqësisë për humbjen e pjesës më të madhe të “provincës së dikurshme të sa”¹⁹⁸.

Nëse Serbia si strategji ushtarake e zgjedh sulmin konvencional, atëherë gjasat janë të mëdha që qëllim politik do të jetë aneksimi i Veriut të Kosovës, meqë në pjesën tjetër të vendit Serbia do ta ketë të pamundur t’i fitojë “shpirtrat dhe mendjet” e popullatës shqiptare. Nuk ka dyshim që Serbia do ta fitojë këtë luftë të kufizuar, duke e patur parasysh disbalancin e plotë të aftësive ushtarake të Kosovës për mbrojtjen konvencionale të territorit të vet. Për më tepër, për shkak të asaj që kjo pjesë e territorit të Kosovës banohet kryesisht nga pjesëtarët e komunitetit serb, Prishtina nuk do ta ketë mundësinë e organizimit të ndonjë lufte guerile për zbrapsjen e pushtimit të kufizuar nga ana e Serbisë.

¹⁹⁶ <http://www.dw.com/sq/shtohen-masat-e-siguris%C3%AB-n%C3%AB-kosov%C3%AB-rrezik-nga-terrorizmi/a-18875524>

¹⁹⁷ Vendi ynë nuk është target i terroristëve”, ka deklaruar bindshëm Islami. Ky njohës i çështjeve të sigurisë beson se renditja e Kosovës si shtet me rrezikshmëri të lartë të terrorizmit nga Departamenti i Shtetit Amerikan mund të ketë ardhur pas numrit të kosovarëve që janë pjesë e luftërave në Siri.

¹⁹⁸ Shih më tepër në: North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice, Europe Report N°211, International Crisis Group, 14 March 2011, p. i.

Nga ana tjetër, nëse si strategji sulmuese ushtarake zgjedhet barbaria, atëherë qëllimi politik i Serbisë do të jetë i njëjtë me atë që Millosheviqi e kishte gjatë luftës 1998-1999: pushtimi i pjesës më të madhe të territorit të Kosovës, së bashku me shpopullimin e tij nga shumica shqiptare. Në këtë rast, strategjia e Kosovës kundër sulmit të Serbisë, sipas të gjitha gjasave, do të jetë lufta guerile e kombinuar me forca konvencionale¹⁹⁹.

Duke pasur parasysh natyrën e tij simbiotike dhe lidhshmërinë me strukturat e caktuara shtetërore, observimi i krimit të organizuar depërton në çështjet e ndjeshme të politikës dhe pushtetit, duke iu nënshtruar kështu ndikimeve dhe manipulimeve politike. Rreziku i tij dhe efekti shkatërrues qëndron në atë se paraqitet në sferat më të ndjeshme të jetës shoqërore, me kanosjen për identifikimin, me totalitetin e tyre të personifikuar me shtetin²⁰⁰.

Sipas Konventës së Palermos, parandalimi i krimit të organizuar në planin ndërkombëtar është përqendruar në këto kërkesa:

- harmonizimi i legjislacioneve penale në pranimin e përkufizimeve të njëjtësuar për shoqatën kriminale, larjen e parave, korrupsionin, obstrukcionin e drejtësisë, tregtinë me njerëz;
- forcimi i instrumenteve ndërkombëtare për bashkëpunim si dhe krijimi i rrjetit institucional për bashkëpunim (rrjeti i gjykatave dhe i prokurorive);
- aplikimi i konfiskimit dhe parandalimi i transferit të të ardhurave kriminale;
- inkorporimi i teknikave speciale hetimore dhe programeve përmbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë;
- forcimi i aktiviteteve preventive dhe bashkëpunimi në parandalimin e krimit dhjetargëtimi i bashkëpunimit, përkaj parandalimit të terrorizmit, tregtisë me narkotikë, edhe në tri veprat që kanë të bëjnë me protokollet shtesë të Konventës së Palermos si:
 - a) transporti i emigrantëve;
 - b) tregtia me gra dhe
 - c) tregtia me armë

Po ashtu, duke mos harruar që organizatat kriminale nuk njohin probleme kufijsh dhe veprojnë në të gjithë botën dhe se çdo vonesë në bashkëpunim ndërkombëtar për të goditur këtë dukuri negative, kthehet në avantazh të organizatorëve të organizimeve të këtylla²⁰¹

KËNDVËSHTRIMI HULUMTUES

Një anketim i kohëve të fundit në Kosovë tregon se rreth 70 për qind e qytetarëve e shohin ekstremizmin e dhunshëm si sfidën më të madhe për sigurinë kombëtare. Megjithatë, në anketimin e kryer nga Qendra për Studime të Sigurisë një shumicë qytetarësh kanë besim në riintegrimin e luftëtarëve të huaj. Drejtuesit e kësaj qendre thanë se Kosova ka nevojë për një bashkërendim më të ngushtë mes institucioneve në mënyrë që të rinjtë të mos përfshihen në ekstremizëm.

STUDIME TË SIGURISË NË KOSOVË

Një raport i Qendrës për Studime të Sigurisë në Kosovë, vë në pah se 70 për qind e qytetarëve e shohin ekstremizmin e dhunshëm si sfidën më të madhe për sigurinë kombëtare. Por, po ashtu një shumicë e qytetarëve beson së të kthyerit nga luftërat e huaja duhet t'u nënshtrohen programeve të rehabilitimit dhe riintegrit. Këto të dhëna u bënë të ditura gjatë publikimit të një raporti mbi gjendjen aktuale të përfshirjes së institucioneve dhe komunitetit në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Skënder Perteshi, nga kjo qendër tha se rreziqet nga ekstremizmi i dhunshëm shtohen në një shoqëri ku të rinjtë janë të papunë dhe pa mundësi të zhvillimit.

„Shkalla më e lartë e papunësisë është te të rinjtë, po ashtu edhe moshë mesatare e qytetarëve tanë që iu kanë bashku këtij konflikti është më e reja në Evropë, është diku mes 24-26 afërsisht, mund të jetë më shumë më pak por këtu silllet. Pikërisht një mundësi shumë më e mirë për punësim për të rinjtë një mundësi shumë ma e mirë për të ardhme për të rinjtë, ndikon direkt në reduktimin e hapësirës së organizatave të ndryshme për me rekrutuar ose përfituar mendje të qytetarëve tonë për ekstremizëm të dhunshëm”, ka theksuar Skënder Perteshi. Sipas raportit 54 për qind e qytetarëve besojnë së të kthyerit nga lufta duhet t'u nënshtrohen programeve të riintegrit, 24 për qind mendojnë se ata duhet të arrestohen menjëherë .

¹⁹⁹ KIPRED, Kosova në kontekstin e sigurisë dh të mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor, Punim i Politikav nr. 3/14-shtator 2014, fq 65

²⁰⁰ Vllado Kambovski, |Krimi i organizuar - aspekte politike”, Tetovë, 2009, fq 10.

²⁰¹ Ismail Zejneli, Kriminaliteti i organizuar-aspekte, Tetovë, 2009, fq 78

Nga qytetarët e anketuar rreth 60 për qind mendojnë se të kthyerit duhet të ri pranohen në komunitet, por me mbikëqyrje nga shteti.

Drejtori ekzekutiv i kësaj qendre, Florian Qehaja, ka theksuar se Kosova ka një kuadër të mirë të ligjeve dhe politikave për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, por problemet shfaqen në zbatimin e tyre. Duke paraqitur një pjesë të raportit që mbështetet mbi siç thuhet mësimet e nxjerra nga tri komuna të Kosovës, Mitrovicë, Kaçanik dhe Hani i Elezit, ai tha se Kosova ka nevojë për një bashkërendim më të ngushtë me përfshirje të shoqërisë civile dhe të mos nënvlerësohet roli i Bashkësisë Islame.

„Tutje mungesa e mundësive dhe niveli i lartë i papunësisë në tre komunat e përzgjedhura kanë krijuar një konsekuencë të pamenduar ku të rinjtë janë rekrutuar në ideologji ekstreme dhe përfshirje në konflikte të huaja në Siri dhe Irak. Sistemi i dobët i arsimit, një e gjetur që e kemi edhe nga raporti i vitit 2015 si dhe mungesa e aktiviteteve ekstra kurrikulare ka krijuar mundësinë ideale që rekrutuesit të arrijnë agjendat e tyre”, tha Qehaja. Zoti Qehaja vuri theksin edhe tek problemet me regjimin e vizave të cilat kanë që një pjesë e të rinjve të udhëtojnë atje ku është e mundur pa viza duke përfunduar në shkolla konservatore fetare në Lindjen e Mesme²⁰².

Raporti vë në pah se 44 për qind e të anketuarve kanë ndjenja të njëjta ndaj përkatësisë së tyre kombëtare dhe fetare, ndërsa 22% për qind vënë përpara përkatësinë e tyre fetare. Që nga fillimi i konfliktit në Siri, rreth 317 qytetarë të Kosovës besohet se janë përfshirë në konfliktet në Lindjen e Mesme dhe rreth 60 veta kanë humbur jetën. Rreth 120 syresh janë thyer prej andej, kryesisht të zhgënjyer me atë me të cilën janë përballur.

Në pyetjen e gazetës së përditshme „Epoka e re se Cilat janë masat që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore për parandalimin e këtij fenomeni botëror, duke aluduar në terrozm, Ekserti i sigurisë Burim Ramadan vlerëson se Kosva ka filluar ndërmarrje e masavë në disa nivele.

Në aspektin e parë hyn korniza ligjore, në të cilën Kosova ka avancuar dhe ka bërë angazhime të rëndësishme. Në aspektin e dytë hyn veprimi i mekanizmave të zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë.

Në këtë kuptim, Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm duke arrestuar, akuzuar dhe dënuar persona të ndryshëm, ndërsa të tjerë janë në procedurë gjyqësore.

Në aspektin e tretë hyn përdorimi i mekanizmave të butë apo parandalimi, më pas rehabilitimi dhe riintegrimi i të radikalizuarve. Tek kjo pjesë mbetet më shumë për angazhim të përbashkët shoqëror dhe institucional.²⁰³

REKOMANDIME

- Institucionat shtetërore të jenë më të kujdeshme dhe drejtuesit e mediave duhet të kërkojnë mundësi për të siguruar lajme të sakta dhe precise pa urrejtje dhe tendenca.
- Partneritetet me institucione arsimore, shkëmbime me media jofitimprurëse dhe ose media publike kombëtare ndërkombëtare të kenë një qëndrim të përbashkët në luftën kundër terrorizmit si faktorë kryesor për sigurinë e përgjithshme.
- Institucionet fetare dhe predikuesit fetarë të kenë programet e tyre vjetore për ligjeratat me qasje që most ë ketë mundësi keqpërdorimi besimtarët.
- Shteti duhet të hartojë programe trajnimi për gjyqtarë e prokurorë në lidhje me legjisllacionin për veprat penale terroriste dhe nxitje për urrejtje, praktikat më të mira dhe implementimin e tyre.
- Programet profesionale të arsimit juridik duhet të përbajnë module që fokusohen në zbatimin e ligjeve.
- Qeveria duhet të fillojë shqyrtimin e çështjeve kryesore të Sigurisë në lidhje me zbatimin e Ligjit për qasje në dokumente publike si e drejte kolektive dhe njerëzore, si dhe të propozojë ose ndryshimin e ligjit, ose procedura për të përmirësuar zinxhirin e zbatimit të tij.
- Organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë duhet të avokojnë dhe të bëjnë presion tek institucionet për të rritur ndjekjen e krimeve politike dhe lirisë së kolektive.
- Përveç kësaj, institucionet lokale duhet të punojnë më ngushtë me mediat, për të siguruar
- përkrahje me kohë dhe të organizuar në rastet e dhunës, frikësimit apo kërcënimeve.

LITERATURA

- [1] Marc Weller, The Challenged State, KOHA, June, 2011,
- [2] Carl Schmitt “Constitutional Theory”, Duke University Press, London 2008,

²⁰² www.zeriamerikes.com/a/kosova-ekstremizmi-dhe-siguria-kombetare-/3721941.html

²⁰³ <http://www.epokaere.com/sq/Intervista/Balkani-dhe-Kosova-rrezikohen-nga-terrorizmi->

- [3] Alan Collins, *Studies on Modern Security*, UET, Tirana,
- [4] Georges Castellan, *History of the Balkans*, Gutenberg, Pristina
- [5] Rrustem Qehaja, *Issues of Balkan national history*, Pristina 2004,
- [6] Stefan Karastojanov, *Kosovo Geopolitical Analysis*, Serembe, Skopje, 2007,
- [7] Bjetush Gashi, *Yugoslav Army and its presence in Kosovo during the period 1945-1990*, Pristina, 2006,
- [8] Fisnik Sadiku, *Understanding of intelligence services*, Mitrovica 2015,
- [9] Fatos Haziri, *The Right of Police*, Pristina 2010,
- [10] Veton H. Zejnuallhi, *Managing and Resolving Regional and International Conflicts*, Prishtina, 2016,
- [11] Ferdinand Xhaferaj, *Balkan Deballing*, Dudaj, Tirana, 2007,
- [12] *Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit*, North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice, Europe Report N°211,
- [13] International Crisis Group, 14 March 2011, p. i.